




# **BINDJET DHE TË VËRTETAT RRETH PARASË**

**Bindjet për çështje të caktuara,  
në disa raste edhe pse tingëllojnë të  
besueshme, nuk përkojnë me realitetin.**

**Të gjithë kemi hasur në bindje dhe  
pohime të ndryshme për paratë nga  
njerëzit e afërt apo miqtë.**

**Bindjet e paqëndrueshme është mirë të  
përpiqemi t'i çrrënjoshim, në mënyrë që të  
zgjerojmë horizontin e njohurive  
financiare.**





**1**

**UNË NUK FITOJ MJAFTUESHËM  
PËR TË KURSyer!**




Kjo është njëra nga bindjet/pohimet që e dëgjojmë më së shpeshti, dhe të cilës shpesh i nënshtrohemi, duke mos tentuar fare që të kursejmë, me arsyetimin se nuk fitojmë aq sa për të kursyer.



**E vërteta**

Është më së lehti të arsyetohemi duke e konsideruar si të pamundur kursimin për shkak të ardhurave të vogla. Por çështja nuk është te të ardhurat por tek shpenzimet. Sepse pavarësisht sa janë të ardhurat tona, gjithmonë mund të gjejmë mënyrën për të kursyer sado pak. Këtë mund ta arrijmë duke i menaxhuar me përgjegjësi financat tona dhe duke e planifikuar buxhetin tonë personal në detaje.





2

**UNË E MERITOJ KËTË,  
PAVARËSISHT ÇMIMIT!**




Shpesh zgjedhim ta shpërblejmë veten duke shpenzuar.

Këtë e arsyetojmë me rastin e festave apo datave të rëndësishme për ne dhe për të afërmit tanë.



**E vërteta**

Nuk ka asgjë të keqe ta shpërblejmë veten dhe të afërmit tanë me ndonjë dhuratë. Por edhe në ato raste duhet të jemi të kujdesshëm duke mos i tejkaluar mundësitë tona buxhetore, sepse periudha e pendimit do të zgjas më shumë se sa entuziazmi momental që e kemi përjetuar gjatë blerjes.





3

**ËSHTË NË ZBRITJE,  
OFERTË E MIRË!**



Shumë shpesh tundohemi të blejmë gjëra sepse janë në zbritje, duke e konsideruar se po kursejmë në të njëjtën kohë.

Të marrim shembull të Premten e Zezë.

Nëse një TV që kushton 1000 euro, shitet për 700 euro, shumë njerëz vendosin ta blejnë atë vetëm pse është në ofertë edhe pse kanë një TV në shtëpi, por që është një model më i vjetër se ai në ofertë, duke llogaritur se po i kursejnë 300 euro.



**E vërteta**

Në fakt ju nuk i keni kursyer 300 euro, por i keni shpenzuar 700 euro. Natyrisht, nëse keni nevojë për blerjen e një TV, përpiquni ta blini kur është në zbritje/ofertë, por mos blini gjëra që nuk ju duhen vetëm sepse janë në zbritje/ofertë.





4

**UNË E KONTROLLOJ RREGULLISHT  
LLOGARINË BANKARE NË MËNYRË  
QË TË MOS KEM NEVOJË PËR  
PLANIFIKIMIN E BUXHETIT!**




Mendoni se informatat e përditësuara mbi gjendjen e llogarisë tuaj bankare, janë të mjaftueshme për menaxhim të mirë të buxhetit.



**E vërteta**

**Kontrollimi i llogarisë bankare në një aplikacion në telefon mobil ose në internet nuk është e njëjtë me buxhetimin, sepse buxhetimi është planifikim.**

**Planifikojeni paraprakisht buxhetin për çdo muaj, në mënyrë që të keni një pasqyrë të përafërt të shpenzimeve gjatë muajit të ardhshëm.**





5

**UNË JAM ENDE I RI,  
NDAJ ËSHTË HERËT TË FILLOJ TË  
KURSEJ PËR KOHËN E PENSIONIMIT!**



Kur jeni në të 20-at, pensionimi është ndoshta gjëja e fundit që keni në mendje, duke e shtyrë këtë mendim kur t'i afroheni pensionimit, por atëherë mund të jetë shumë vonë.



**E vërteta**

Duke qenë se moshë e pensionimit është 65 vjeç do të ishte mirë të filloni të mendoni për kohën pensionimit qysh në të 20-at. Të supozojmë që ju arrini të kurseni 50 euro në muaj apo 600 euro në vit. Nëse filloni me kursim në moshën 25 vjeçare atëherë në moshën e pensionimit do të keni 24 mijë euro të kursyera, ndërsa nëse filloni në moshën 35 vjeçare atëherë shuma e parave të kursyera deri në moshën e pensionimit do të jetë 18 mijë euro. D.m.th. sa më shumë që e shtyni fillimin e kursimeve, aq më e vogël do të jetë shuma e kursyer kur të arrini moshën e pensionimit.

**Prandaj bëni përpjekje që sa më herët  
të filloni për të kursyer.**

